



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 230 prot.

Tiranë më 29.1.2018

**VENDIM**

Nr. 02, datë 29.01.2018

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

**V Ë R E N:**

Ankuesi, Z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1334 Prot., datë 10.10.2017, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik"). Me kërkesën për informacion të depozituar pranë Autoritetit Publik me datë 20.09.2017 dhe nr. Prot 0560/1, ankuesi ka kërkuar vënien në dispozicion të kopjeve të vendimeve gjyqësore mbi çështjet ose kërkesat penale ku kanë qenë palë shtetasit Gjini Gjoni dhe E.Ç.

Me shkresën nr. 16157 Prot., datë 03.10.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: "*Vendimet gjyqësore nuk janë dokumente të zakonshëm që mund të vihen në dispozicion të kujtdo që i kërkon, pasi aty ka të dhëna sensitive vetjake për palët dhe si të tilla nuk mund të shpërndahen pa miratimin e palëve që u përkasin në mbështetje të kërkesave të ligjit 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Publikimi i tyre në faqen elektronike të Gjykatës, lidhur kjo me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore bëhet vetëm pasi janë enkriptuar të dhënat vetjake duke u bërë anonimizimin sipas Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë 4059/2 "Pë anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave".*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1334 Prot., datë 10.10.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në lidhje me refuzimin e vënies në dispozicion të informacionit të kërkuar, ankuesi pretendon se: *"Neni 142 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 2, shprehet se vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast, çka do të thotë se këto lloj dokumentesh nuk gëzojnë klasifikim sekret. Gjykata e Lartë, e cila garanton me anë të jurisprudencës së saj zbatimin uniform të ligjeve, i bën publike këto vendime pa miratimin e palëve. Mbrojtja e të dhënave personale, si adresa banimi apo llogari bankare është përgjegjësi e autoritetit publik të bëjë anonimizimin e tyre dhe jo të refuzojë kërkesën"*

Zyra e Komisionerit konstaton se, arsyetimi i Autoritetit Publik lidhur me refuzimin e dhënies së informacionit të kërkuar, bazuar në Udhëzimin nr. 4059/2 datë 7.6.2016 "Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave" është i gabuar.

Qëllimi i këtij Udhëzimi nuk është pengimi i transparencës dhe kufizimi i së drejtës së informimit lidhur me vendimet gjyqësore, por përcaktimi i detyrimeve të gjykatave në cilësinë e autoritetit publik në garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale të subjekteve të pëfshira në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo në to, si një e drejtë themelore e barazvlefshme me të drejtën për informim.

Gjithashtu, për sa i përket rastit konkret, sqarojmë se bazuar në gërmën b), pika 4 e nenit 4, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, *"Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publikë zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre"*.

Në këto rrethana, Autoriteti Publik duhet të trajtojë kërkesën për informacion lidhur me personin që kryen funksione publike në përputhje me pikën 4, të nenit 4, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe për sa i përket palëve të përfshira në çështjet objekt ankimi, duke respektuar Udhëzimin Nr. 4059/2, datë 7.6.2016 "Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave".

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kufizimet e pasqyruara në legjislacionin e zbatueshëm nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar dhe si rrjedhojë Autoriteti Publik duhet të trajtojë kërkesën për informacion, në përputhje me pikën 6, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe duke respektuar nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. \_\_\_\_\_ kundër Autoritetit Publik Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër lidhur me kufizimet në dhënie e informacionit, ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës Nr. 1334 Prot., datë 10.10.2017 të Z. \_\_\_\_\_, ndaj Autoritetit Publik "Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan", me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës për informim datë 10.09.2017 në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", si dhe duke respektuar nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, brenda datës 05.01.2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 29.1.2018.

### KOMISIONERI

